



**QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
MINISTRIA E PUNËS DHE E POLITIKËS SOCIALE**

LAJMËRIM

**për shfrytëzimin e shërbimit rekreacion klimaterik në banjë për përfituesit
e pensionit, për vitin 2015**

Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale u bën thirrje të gjithë pensionistëve të interesuar që të paraqiten për shfrytëzimin e shërbimit rekreacion klimaterik në banja.

Këtë shërbim mund të shfrytëzojnë personat-pensionistët që marrin pension pleqërie, pension invalidor dhe pension familjar që e kanë fituar sipas normave të Republikës së Maqedonisë dhe normave nga marrëveshjet për sigurim social që Republika e Maqedonisë i zbaton, e të cilët jetojnë në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe drejtën e pensionit e kanë arritur përfundimisht me dhjetorin e vitit 2014.

Ky shërbim mund të shfrytëzohet vetëm një herë, në muajt mars deri në nëntor të vitit 2015, në kohëzgjatje prej 7 ditëve. Termi i lejuar për shfrytëzimin e këtij shërbimi nuk mund të ndryshohet, përveç në rastet kur paraqiten pengesa apo për shkak të sëmundjes.

Shërbimi në fjalë përfshinë:

- 6 pansione të plota (fjetje me tri racione)
- Terapi në banja
- Një kontrollim i obliguar shëndetësor
- Shpenzimet për transport në shumë të biletës kthyesë të autobusit nga vendbanimi i shfrytëzuesit deri te lokacioni ku do të shfrytëzohet ky shërbim (shpenzimet e transportit do të paguhen përmes llogarisë transaktive të shfrytëzuesit pas shfrytëzimit të shërbimit).

Pensionistët që shfrytëzojnë edhe kompensime në të holla për ndihmë dhe përkujdesje nga person tjetër, shtesë për mobilitet apo verbësi kanë të drejtë për shoqëruar gjatë shfrytëzimit të këtij shërbimi.

Shërbimi i rekreacionit klimaterik realizohet me subjektet juridike të regjistruara për kryerjen e shërbimit për shërim klimaterik në banja, me të cilat Ministria e Punës dhe Politikës Sociale do të lidhë marrëveshje.

Dokumentet e nevojshme që përfituesi i pensionit duhet t'i dorëzojë për shfrytëzimin e këtij shërbimi:

Për shfrytëzimin e shërbimit rekreacion klimaterik në banja pensionistët duhet të parashtrorjnë **kërkesë** në Njësinë rajonale të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë, sipas vendbanimit të tyre. Kërkesën e jep Njësia Rajonale e Fondit.

Në kërkesë përfituesi i pensionit mund të përcaktohet ta shfrytëzojë shërbimin e rekreacionit klimaterik në banjë për përfituesit e pensionit për vitin 2015 apo vikend turistik falas për përfituesit e pensionit për vitin 2015.

Nëse përfituesi i pensionit shfrytëzon edhe pjesë nga pensioni të cilin e merr nga ndonjë shtet tjetër, **doemos** duhet të parashtrorjë edhe çekun nga banka për shumën mujore të pensionit.

Gjatë rangimit të kërkesave të parashtruara, prioritet do t'u jepen pensionistëve të cilët para pensionimit kanë punuar në miniera dhe pensionistëve që janë përfitues të pensionit invalidor me invaliditet të lartë të përcaktuar.

Kërkesat mund të parashtrohen deri më 16 shkurt të vitit 2015

Pas përfundimit të procedurës, Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë me shkrim do ta informojë parashtruesin e kërkesës për entin ku do të dërgohet dhe për periudhën e shfrytëzimit të këtij shërbimi.

Listat e përfituesve të pensionit, të cilëve u është miratuar shfrytëzimi i këtij shërbimi do të publikon në Njësitë Rajonale të Fondit, si dhe në ueb faqen e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale www.mtsp.gov.mk dhe në ueb faqen e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë www.piom.com.mk

Theksojmë se personat-përfituesit e pensionit të cilët në vitin 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014 e kanë fituar të drejtën ta shfrytëzojnë shërbimin rekreacion klimaterik në banja, nuk mund të shfrytëzojnë këtë shërbim edhe në vitin 2015.